UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.4196/1, datë 17.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 12.2.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" dhe të paragrafit të parë të nenit 47 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2009 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në titullin e udhëzimit, fjala "privat" zëvendësohet me fjalën "shtetëror".

1. Në pjesën hyrëse të udhëzimit, hiqet baza ligjore që referon paragrafin e parë të nenit 47 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".

2. Në shtojcën nr.1, në tabelën B, në ndarjen "Tarifa për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror dhe privat", hiqen fjalët "dhe privat".

3. Tarifat e përcaktuara në tabelën B të shtojcës nr.1, zbatohen vetëm për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode